

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, e rishpall këtë:

KONKURS PUBLIK

për angazhimin me kontratë për punë dhe detyra specifike sikurse në vijim:

Titulli i pozitës: DIZAJNER I UEBFAQES

Orët e punës: Jo më shumë se 120 ditë në vit (kryesisht punë në distancë)

Numri i referencës: R-KON012026

Kohëzgjatja e emërimit: Kontratë për punë dhe detyra specifike

Adresa e institucionit: Rr. "Perandori Justinian" Nr. 71, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë e dizajnerit:

- Të ndihmojë ekipin e FKPK-së në përgatitjen e ndryshimeve dhe përditësimeve të uebfaqes.
- Të përgatisë propozime të ndryshimeve, plotësimeve dhe përditësimeve të uebfaqes.
- Të bashkëpunojë (kur ka nevojë) me palë të treta për të realizuar detyra të caktuara të dizajnit të uebfaqes.
- Të propozojë dizajne dhe ide për përmirësimin e vazhdueshëm të uebfaqes së FKPK-së.
- Të përdorë metoda dhe mjete për të shtuar numrin e vizitorëve të uebfaqes dhe masë numrin e tyre.
- Të jetë i përpiktë në realizimin e kërkesave.

Kriteret e konkursit:

- | | |
|------------------------|--|
| Arsimimi | <ul style="list-style-type: none">Diploma e arsimit të lartë universitar në fushën e dizajnit grafik është përparësi. |
| Njohuritë dhe përvoja: | <ul style="list-style-type: none">Njohuri të avancuara dhe përvojë të dëshmuar (së paku tri vjeçare) si dizajner i uebfaqes në WordPress, si platformë kryesore për zhvillimin dhe menaxhimin e uebfaqes së FKPK-së.Njohuri të avancuara në HTML5, CSS3 dhe JavaScript, të nevojshme për ndërtimin, personalizimin dhe optimizimin e ndërfaqes së përdoruesit.Përvojë në përdorimin e PHP, për personalizimin dhe zgjerimin e funksionaliteteve të WordPress-it.Përvojë në përdorimin e mjeteve për dizajnim dhe prototipim, si Figma (ose mjete të ngjashme).Aftësi për zhvillimin e dizajnit funksional e praktik, të përshtatshëm për përdorim nga pajisje të ndryshme (desktop, tablet dhe telefon).Përvojë në implementimin e praktikave bazike të SEO-së.Njohuri në optimizimin e performancës dhe përdorshmërisë së uebfaqes.Njohuri në testimin dhe sigurimin e përputhshmërisë së uebfaqes me shfletues dhe pajisje të ndryshme. |
| Dëshmitë: | <ul style="list-style-type: none">Të gjitha deklaratimet për arsimimin, certifikimet dhe përvojën e punës do të duhet të dëshmohen dhe konfirmohen para nënshkrimit të kontratës me kandidatin e përzgjedhur. |

Mënyra e vlerësimit:

- Komisioni Vlerësues do t'i vlerësojë kandidatët sipas: përvojës profesionale, portofolit, arsimimit (diplomave dhe certifikatave) paraqitjes në intervistë dhe ofertës financiare.

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur për periudhën: **9 shkurt deri më 23 shkurt 2026 në ora 16:00 (CET).**
- Aplikimi bëhet vetëm përmes email-it në adresën: **recruitment@trusti.org**, me referencë: **"Dizajner i uebfaqes"**.
- Email-it për aplikim duhet t'i bashkëlidhen dokumentet në vijim: 1) Biografia (CV); 2) Letërmotivimi, 3) Dëshmitë e shkollimit dhe certifikimeve (nëse ka); 4) Dëshmitë e përvojës së punës dhe portofoli përkatës dhe 5) Certifikata e historisë penale.

Vërejtje: Aplikacionet pa dokumentet e lartcekura të bashkanqitura, ose që nuk janë në formatin e kërkuar, NUK do të shqyrtohen. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet do të kontaktohen.

FKPK-ja është punëdhënëse që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!